



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KRYETARI

Nr. 10434 prot.

Korçë më, 07 / 11 / 2019

**URDHËR**

Nr. 872, datë 07 / 11 / 2019

**Mbi subjektet që do të liçencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Korçë**

Pas shqyrtimit dhe miratimit të relacionit të paraqitur nga Komisioni Vlerësues në transportin e udhëtarëve në linja të rregullta rrethqytetëse, të datës 04.11.2019, bazuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 64, pika a; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar, neni 11, pika 7/a;

**URDHËROJ:**

1. Subjektet fituese në konkursin e zhvilluar prej 16.10.2019-31.10.2019, "Për përzgjedhjen e subjektit / subjekteve, që do të liçencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Korçë", në të cilat nuk ka operator të liçencuar, do të jenë:
  - 1/1. Subjekti "Niko Xega", me NUIS L94616004U, me autobusin me targë AA993UH, në linjën Gjonomadh-Korçë-Gjonomadh.
  - 1/2. Subjekti "Gertian Bashllari", me NUIS L54814001L, i cili disponon autobusët me targa KO9532B dhe AA697IO, në linjën Turan-Korçë-Turan,
2. Të vijohet më tej me procedurën e liçencimit për këto subjekte, në linjat Gjonomadh-Korçë-Gjonomadh dhe Turan-Korçë-Turan.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi  
N. Lika

Drejtoria e Përgjithshme  
Juridike  
A. Dishnica

KRYETARI  
Sotirag Filo

